



## Titulli i projektit

Zyra e Shërbimeve me Një Ndalesë - ZSHNJN (Bashkia Klos)

## Tipi i projektit

Shërbimet Publike

## Vendndodhja e projektit

Klos, Suç, Xibër, Gurrë

## Buxheti i paravlerësuar

Për t'u përcaktuar, por jo më pak se 13,000,000 lekë

## Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Në situatën e re të dalë nga shkrija dhe bashkimi i njësive të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritet të jetë një prej rrjedhojave bazë të synuara. Ruajtja e stadit të arritur në shërbimet aktuale dhe përmirësimi i mëtejshëm, janë tendenca që duhet të ecin paralelisht. Aktualisht nuk ka asnjë praktikë të shërbimeve të këtij lloji në komunat që duhet të shkrihen, kështu që puna duhet nisur nga e para. Kjo është e rëndësishme sidomos për shërbimet e mbështetjes së zhvillimit ekonomik (dhënie licensash, lejesh për ushtrim aktiviteti, pagime tarifash dhe taksash lokale, planifikim urban, mirëmbajtje e pyjeve, etj.), si dhe shërbimet e tjera të karakterit administrativ (gjëndja civile, përkrahja sociale, etj.). Ofrimi i shërbimeve me një zyrë mbështetëse dhe disa zyra pararojë në secilën nga njësitë shkrija, do të risë efektivitetin e shërbimit, duke ruajtur shkallën e shërbimit të arritur.

## Qëllimi/et specifik të projektit

ZSHNJN do të sigurojë shërbimet publike në zonat e shkrija në mënyrë më efektive dhe me cilësi më të lartë, duke rritur transparencën me publikun.

## Rezultatet e pritshme dhe treguesit

- Rritja e efektivitetit të shërbimeve publike për qytetarët e bashkisë Klos (total i popullsisë më tepër se 16000 banorë);
- Zvogëlimi i kostos së shërbimeve publike për banorë, si pasojë e zvogëlimit të kostos së personelit dhe të kohës së harxhuar për njësi shërbimi ( më tepër se 30%);
- Rritja e transparencës dhe cilësisë së shërbimeve publike nëpërmjet futjes së praktikës së shërbimeve të hapura (100%).

# PROJEKTI 2



program i zonave funksionale

# pzf

## Aktivitetet e projektit

- Prezantim i konceptit dhe përfitimet e një ZSHNJN;
- Rinovimi dhe adaptimi i ambientit të ZSHNJN;
- Kompletimi i ZSHNJN me pajisjet bazë;
- Punësim personeli, trajnimi dhe testimi
- Zhvillimi i materialeve promociionale (logo e ZSHNJN, shenja, fletushka, kuti postare për qytetarët, komentet dhe ankesat).

## Maturimi i projektit

Aktualisht nuk ka asnjë praktikë të shërbimeve të këtij lloji në komunat që duhet të shkrihen, kështu që puna duhet nisur nga e para. Ekziston një projekt pilot i zhvilluar nga program dldp për njësinë Lezhë, apo Kallmet, që mund të zbatohet në këto zona.

## Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

### Burimet e Financimit:

- Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
- Transferata e Pakushtëzuar
- Donatorët
- Fondi i Mbështetjes së Decentralizimit

### Partnerët:

- Bashkia Klos
- Qeveria Qëndrore dhe Këshilli i Qarkut
- Donatorë: UNDP, OSBE, BE

## Kostot e projektit

Prezantim i konceptit dhe përfitimet e një ZSHNJN  
Rinovimi dhe adaptimi i ambientit ZSHNJN  
Kompletimi i ZSHNJN me pajisjet bazë  
Punësim personeli, trajnimi dhe testimi  
Zhvillimi i materialeve promociionale  
Total: Jo më pak se 13,000,000 lekë